


Namazi i xhenazes



E rishikoi dijetari i shquar:
Abdullah ibn Abdurrahman el-Xhibrin
(Allahu e mëshiroftë)



Titulli origjinal i broshurës:

الصلاة الجنابة

(Es-Salatu el Xhenazetu)

Titulli në shqip:

Namazi i Xhenazes

E rishikoi

Dijetari i shquar:

Abdullah ibn Abdurrahman el Xhibrin

(Allahu e mëshiroftë)

Përktheu: **Kastriot Bardhi**

Redaktoi: **Klevi Vinjaku**

Korçë, 2026

Parathënie

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve. Paqja, bekimet dhe mëshira e Allahut qofshin për Profetin tonë, Muhamedin, të fundmin e lajmëtarëve dhe prijësin e të devotshëmve, për familjen e shokët e tij, dhe për të gjithë ndjekësit e tyre besnikë deri në Ditën e Gjykimit.

Kjo broshurë është një përmbledhje e shkurtuar për çështjet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me xhenazën. Materiali është publikuar në arabisht në një nga faqet e internetit më të mirënjohura islame: www.saaidd.net. Teksti i përpiluar bazohet në burime autentike; referencat përmenden në fund të tij. Gjithashtu ai është i pajisur me foto ilustruese.

Është e rëndësishme të theksohet se për herë të parë materiali në fjalë u publikua më dt. 20. 8. 1420 h vetëm pas kontrollit dhe rishikimit nga dijetari i shquar Abdullah ibn Abdurrahman el Xhibrini (Allahu e mëshiroftë).

Falënderoj gjithë vëllezërit që ndihmuan në publikimin e kësaj broshure në gjuhën shqipe, veçanërisht vëllain e nderuar, Klevi Vinjaku, i cili më nxiti ta nxjerr nga arkivat e mia këtë tekst të përkthyer afërsisht para një çerku shekulli, për t'u sjellë sadopak dobi muslimanëve në përgjithësi dhe imamëve në veçanti.

E lus Allahun ta bëjë këtë vepër modeste të sinqertë për të Tij, dhe të na bëjë dobi të gjithëve.

Përkthyesi

Korçë, më 25 qershor 2026

1. Agonia e vdekjes, veprimet e para për përgatitjen e xhenazes

♦ **Muslimani duhet të përgatitet për vdekjen** duke i shtuar veprat e mira dhe duke u larguar nga ndalesat, si dhe ta ketë atë gjithmonë të pranishme në mendje, bazuar në fjalën e Profetit ﷺ: **“Shtojeni përmendjen e shkatërruesit të kënaqësive (vdekjes).”** (1)

♦ Kur muslimani vdes, atëherë **ata që janë pranë tij duhet të veprojnë disa gjëra:**

1. **T’ia mbyllin sytë**, sepse Profeti ﷺ ia mbylli sytë Ebu Selemes (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) dhe tha: **“Kur del shpirti, atë e ndjek shikimi.”** (2)
2. **T’ia lirojnë nyjet e trupit** që të mos ngurtësohen, dhe t’i vendosin në bark diçka në mënyrë që të mos fryhet.
3. **Ta mbulojnë me një rrobë që ia mbulon tërë trupin**, bazuar në fjalën e Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të): **“Kur i Dërguari i Allahut ﷺ ndërroi jetë, u mbulua me një mantel me vija.”** (3)
4. **Të shpejtojnë për përgatitjen e xhenazes, për faljen e namazit dhe varrosjen e tij**, bazuar në fjalën e Profetit ﷺ: **“Shpejtoni me xhenazen.”** (4)
5. **Ta varrosin në vendin ku ka vdekur**, sepse Profeti ﷺ në betejën e Uhudit urdhëroi që të vrrarët (martirët) të varrosen në vendet e tyre, pra në vendet ku ndërruan jetë, dhe të mos transportohen.

2. Larja e xhenazes

♦ **Larja e xhenazes, qefinosja, falja e namazit të xhenazes dhe varrosja e të ndjerit janë *farz kifaje*** (obligim kolektiv); nëse disa muslimanë e kryejnë këtë, bie mëkati nga të tjerët.

♦ **Personi më parësor që ka të drejtë të lajë të vdekurin është ai që i ndjeri e ka lënë me porosi** (amanet), pra personi të cilit i ka kërkuar që ta lajë pas vdekjes së tij.

♦ **Pastaj vjen babai i tij**, sepse ai është më i mëshirshëm dhe më i dhembshur, si dhe më i ditur se i biri; **pastaj të afërmit sipas radhës së afërsisë**.

♦ **Femrën e lan ajo që e ndjera ka lënë porosi**, pastaj nëna e saj, pastaj vajza e saj, **pastaj më të afërmet me radhë**.

♦ **Bashkëshorti lejohet ta lajë gruan e tij**, bazuar në fjalën e Profetit ﷺ për Aishen (Allahu qoftë i kënaqur me të): “**Çfarë do të të dëmtonte sikur të vdisje para meje dhe unë të të laja ty...**”. (6) Edhe gruas i lejohet të lajë burrin e saj të vdekur, sepse Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur me të) kishte lënë porosi që ta lante gruaja e tij. (7)

♦ **Burri dhe gruaja lejohen të lajnë fëmijën që është nën shtatë vjeç**, qoftë djalë apo vajzë, sepse pjesët intime të tij nuk kanë të njëjtin gjykim si për të rriturit.

♦ **Nëse vdes një burrë mes grave, ose një grua mes burrave, atëherë nuk lahet, por i jepet tejemum**: një nga të pranishmit godet tokën me duart e tij dhe më pas fshin fytyrën dhe duart e të vdekurit.

♦ **Është e ndaluar që muslimani të lajë ose të varrosë jomuslimanin**, bazuar në fjalën e Allahut: “**Asnjërit prej tyre mos ia fal namazin kur të vdesin...**” (8) Përderisa është ndaluar falja për ta, që është gjëja më e rëndësishme, atëherë ndalohet edhe çdo gjë tjetër që është më pak e rëndësishme.

♦ **Është e pëlqyer (sunet) gjatë larjes së të vdekurit që të mbulohet auroti** (organi intim) i tij, pastaj **t’i hiqen rrobat dhe të mbulohet nga shikimet e njerëzve**, sepse mund të jetë në një gjendje të papëlqyer (**shih figurën 1**).



Pastaj i ngrihet koka afër pozicionit të uljes dhe **i shtypet barku lehtë që të dalë gjithçka që mund të ketë brenda**, dhe në atë moment shtohet derdhja e ujit që të pastrohen papastërtitë që dalin prej tij (**shih figurën 2**).




Pastaj larësi mbështjell një copë (ose vendos dorashkë) në dorën e tij dhe me to pastron të vdekurin, pra **lan organet e tij intime**, pa e parë auringun dhe pa e prekur drejtpërdrejt, nëse i vdekuri është shtatë vjeç e më shumë (**shih figurën 3**).



Pastaj e përmend emrin e Allahut (thotë: Bismilah) dhe **i jep abdes si abdesi i namazit**, bazuar në fjalën e Profetit ﷺ për vajzat e tij: **“Filloni nga ana e djathtë dhe nga pjesët e abdesit.”** (9)

Larësi nuk fut ujë në hundë dhe në gojë, por fut gishtat e tij të mbështjellë me një copë të lagur midis buzëve të të vdekurit dhe pastron dhëmbët e tij, si dhe në vrimat e hundës për t’i pastruar ato.

Pastaj është e pëlqyer që t’i lahet koka dhe mjekra me shkumën e sidrit (gjetheve të sidrit) (**shih figurat 4 dhe 5**), ndërsa pjesa tjetër e sidrit përdoret për trupin



Pastaj lahet ana e tij e djathtë, nga pjesa e përparme (shih figurën 6) dhe pastaj nga pjesa e pasme (shih figurën 7). Kështu veprohet edhe me anën e majtë. Kjo bazohet në hadithin e mëparshëm: “Filloni me anën e djathtë.”



Pastaj kjo përsëritet për herë të dytë dhe të tretë, sipas fjalës së Profetit ﷺ në hadithin e mëparshëm: “Lajeni atë tre herë.” Në çdo larje, larësi kalon dorën e tij mbi barkun e të ndjerit. Nëse del ndonjë papastërti, e pastron.

Ai që e lan të vdekurin lejohet të shtojë larjet mbi tre herë deri në shtatë, madje edhe më shumë se shtatë herë, nëse ka nevojë për këtë.

Është e pëlqyeshme që në larjen e fundit të vendoset *kafur* (kamfur), sipas fjalës së Profetit ﷺ në hadithin e mëparshëm: “Vendosni në larjen e fundit kafur.” Ai është një parfum i njohur, me aromë të ftohtë, dhe era e tij largon insektet. (shih figurën 8)



Është e pëlqyeshme që i vdekuri të lahet me ujë të ftohtë, përveç nëse ai që e lan ka nevojë për ujë të ngrohtë për shkak të papastërtive të shumta në trupin e të ndjerit. Gjithashtu atij i lejohej të përdorë sapun për heqjen e papastërtisë, por nuk duhet ta fërkojë me forcë që të mos i dëmtohet lëkura. Sikurse i lejohej t’ia pastrojë dhëmbët.

Është e pëlqyeshme që të vdekurit t’i priten mustaqet e dhe thonjtë, nëse janë zgjatur në mënyrë jo të zakonshme. Sa për **qimet e sqetullave dhe të pjesës intime, ato nuk priten.**

Nuk është e pëlqyeshme të krihet flokët e të vdekurit, sepse ato do të bien dhe do të dëmtohen. Ndërsa **flokët e gruas** behen tre gërsheta dhe vendosen pas shpinës.

Pas larjes, është e pëlqyeshme që i vdekuri të fshihet (me peshqir) e t’i thahet trupi.

Nëse nga i vdekuri del papastërti (urinë, jashtëqitje ose gjak) pas shtatë larjeve, atëherë i mbushet organi intim me pambuk, pastaj lahet vendi i papastërtisë, dhe pastaj i jepet abdes (në mënyrën e sqaruar më parë).

Por nëse papastërtia del pas qefinosjes (mbështjelljes), atëherë nuk përsëritet larja, sepse kjo do të sillte vështirësi.

Nëse vdes besimtari që është në gjendjen e ihramit gjatë kryerjes së haxhit ose umres, ai lahet me ujë dhe sidër siç u përmend më parë, por nuk parfumohet dhe nuk i mbulohet koka nëse është mashkull, sipas fjalës së Profetit ﷺ për atë që vdiq në ihram

gjatë haxhit: “Mos e parfumosni”. Gjithashtu tha: “Mos ia mbuloni kokën, sepse ai do të ringjallet në Ditën e Kiametit duke bërë telbije.” (10)

Dëshmori i betejës nuk lahet, sepse Profeti ﷺ urdhëroi që të vrarët e Uhudit të varroseshin me rrobat e tyre dhe të mos laheshin (11). Dëshmori varroset me rrobat me të cilat ka vdekur, pasi i hiqet arma, dhe nuk i falet xhenazja, sepse Profeti ﷺ nuk ua fali namazin e xhenazes dëshmorëve të Uhudit. (12)

Fëmija i lindur i vdekur, nëse ka arritur 4 muaj, lahet, i falet namazi i xhenazes dhe i vendoset emër, sipas fjalës së Profetit ﷺ: “Secili prej jush formohet në barkun e nënës 40 ditë si pikë, pastaj bëhet mpiksje gjaku në po aq ditë, pastaj bëhet copë mishi në po aq ditë, pastaj i dërgohet engjëlli dhe i fryhet shpirti (pra pas 4 muajve)”. (13)

Por para kësaj kohe është vetëm copë mishi dhe varroset kudo pa larje dhe pa namaz.

Kush nuk mund të lahet për shkak të mungesës së ujit, ose sepse trupi është i shpërbërë apo i djegur, atëherë i jepet tejemum. Pra një nga të pranishmit godet tokën me duart e tij dhe ai fshin me to fytyrën e të vdekurit dhe pëllëmbët e tij.

Është e pëlqyeshme për larësin që të mbulojë (fshehë) atë çfarë sheh në trupin e të ndjerit nëse nuk është diçka e mirë, si: errësirë në fytyrën e tij, ose shenja të shëmtuara në trup, e të ngjashme me këto.

Kjo bazohet në fjalën e Profetit ﷺ: “Kush e lan një musliman dhe e ia mbulon të metat (nuk e përhap atë që sheh), Allahu do t’ia falë atij 40 herë.” (14)

3- Qefinosja


Është obligim që i vdekuri të qefinoset (të mbështillet me qefin), dhe shpenzimi i qefinit merret nga pasuria e tij, sipas fjalës së Profetit ﷺ për atë që vdiq në gjendjen e ihramit: “Mbështilteni me dy rrobat e tij.” Ndërkaq, qefinosjes i jepet përparësi ndaj borxhit, testamentit dhe trashëgimisë.

Nëse ai nuk ka pasuri për qefinin, atëherë obligimi bie mbi ata që kanë detyrë të shpenzojnë për të, dhe ata janë të afërmit e tij: prindërit dhe pasardhësit e tij, si: babai, gjyshi, djali ose djali i djalit. Nëse ata nuk gjenden, atëherë shpenzimet mbulohen nga arka e shtetit të muslimanëve. Nëse edhe kjo nuk ekziston, atëherë obligimi bie mbi këdo që e di gjendjen e tij nga muslimanët.

Është obligim që i vdekuri të qefinoset me një rrobë që mbulon tërë trupin e tij.

Është e pëlqyeshme që burri të qefinoset me tre pëlhura të bardha, sepse Profeti ﷺ është qefinosur me tre pëlhura të bardha. (15)

Ato parfumohet me temjan, pastaj shtrihen njëra mbi tjetrën, dhe vendoset *hanut* (që është një parfum i veçantë për të vdekurit) midis tyre (shih figurën 9). Pastaj i vdekuri vendoset mbi to i shtrirë në shpinë (si në figurën 10), pastaj vendoset pambuk i parfumuar midis dy vitheve të tij që të mos dalë prej tij erë e keqe.



Është e pëlqyer që të lidhet një copë pëlhure me pambuk (si në figurën 9), e cila mbulon aurretin e të vdekurit duke u vendosur mbi pjesën intime të tij.



Gjithashtu është e pëlqyer që të vendoset *hanut* – pra parfum – në disa pjesë fytyrës së të vdekurit, si: në sytë, hundën, buzët e veshët, dhe në vendet ku ai ka bërë sexhde. Nëse i vendoset parfum në të gjithë trupin, nuk ka problem, sepse kjo është transmetuar nga disa sahabë.

Pastaj paloset ana e parë e çarçafit të qefinit mbi anën e djathtë të trupit (si në figurën 11), pastaj ana tjetër mbi anën e majtë (si në figurën 12). Pastaj veprohet me çarçafin e dytë njësoj si me të parin, dhe pastaj me të tretin në të njëjtën mënyrë.





Pastaj hiqet pëlhura që mbulonte aurretin (si në figurën 12). Pastaj lidhen nyje – gjithsej shtatë – (si në figurën 15), që të mos hapet qefini, duke u lidhur edhe pjesët e tepërta të qefinit (si në figurën 13).



Pastaj nyjet zgjidhen në varr. Nëse nyjet janë më pak se shtatë, nuk ka problem, sepse qëllimi është vetëm që qefini të qëndrojë i fiksuar.

Lejohet që i vdekuri të mbështillet me një këmishë (një rrobë të vetme) **dhe një izar** (rrobë që mbulon pjesën e poshtme të trupit), por më e mira është ajo që u përmend më parë (d.m.th. qefinosja më e plotë me disa copa qefini).

Gruaja qefinoset me 5 copa: *izar* (që mbulon pjesën e poshtme të trupit), *khimar* (mbulesë për kokën), këmishë (që është si rrobë, por e hapur në anët), dhe dy çarçafë që mbulojnë të gjithë trupin.

4- Namazi i xhenazes

Namazi i xhenazes është *farz kifaje*. Kjo do të thotë se mjafton që ta kryejnë disa prej muslimanëve dhe obligimi bie nga të tjerët.

Është sunet që imami të qëndrojë te koka e burrit (si në figurën 16) dhe te mesi i trupit të gruas (si në figurën 17), ashtu sikurse ka vepruar Profeti ﷺ. (16)



Preferohet që imami të qëndrojë përpara xhematit, por nëse disa nuk gjejnë vend, atëherë ata rreshtohen në të djathtë dhe të majtë të tij.

Imami bën katër tekbire:

Pas tekbirit të parë lexon suren Fatiha, pasi të ketë kërkuar mbrojtje prej Allahut nga shejtani i mallkuar (thuhet *istiadhja*).

Pas tekbirit të dytë dërgon salavate mbi Profetin ﷺ, si në teshehud:

Allâhum-me sal-li alâ Muham-medin ue alâ âli Muham-medin kemâ sal-lejte alâ Ibrâhîme ue alâ âli Ibrâhîme, in-neke Hamîdun Mexhîd.

Allâhum-me bârik alâ Muham-medin ue alâ âli Muham-medin, kemâ bârrakte alâ Ibrâhîme ue alâ âli Ibrâhîme, in-neke Hamîdun Mexhîd. O Allah lavdëroje (te melekët e lartë) Muhamedin dhe familjen e tij, ashtu siç lavdërove Ibrahimin dhe familjen e tij! Vërtet, Ti je i Lavdishëm dhe i Madhëruar. O Allah, bekoje Muhamedin dhe familjen e tij, ashtu siç bekoje Ibrahimin dhe familjen e tij!

Vërtet, Ti je i Lavdishëm dhe i Madhëruar. Dhe nëse e kufizon vetëm duke thënë: “Allahume sali ala Muhamed”, kjo është e lejuar.

Pas tekbirit të tretë, imami lutet për të vdekurin me lutjet që kanë ardhur në Sunet.

Një ndër lutjet e transmetuara është kjo në vijim: **Allâhum-megfir lehu uerrhamhu ue âfihi uea'fu anhu ue ekrim nuzulehu ue ues-si' mud'halehu uegsilhu bil mâi ueth-thelxhi uel berradi, ue nek-kihi minel hatâjâ kemâ nek-kajteth-theubel ebjada mined-denesi, ue ebdilhu dârran hajrran min dârihi, ue ehlen hajrran min ehlihi, ue zeuxhen hajrran min zeuxhihi, ue ed'hilhul xhen-nete ue eidh'hu min adhâbil kabri (ue adhâbin-nâr).**

O Allah! Mbuloja dhe fshija gjynahet, mëshiroje, shpëtoje nga të këqijat, falja të metat, nderoje me mirësi të madhe dhe me vend të lartë në Xhenet, zgjeroja varrin, laje atë nga gjynahet me ujë, borë dhe breshër (fshija të gjitha gjynahet), pastroje atë nga gjynahet, njëlloj sikur pastron rrobën e bardhë nga papastërtitë! Jepi atij një vendbanim më të mirë se ai që kishte, një familje më të mirë se ajo që kishte dhe një bashkëshorte më të mirë se ajo që kishte! Fute atë në Xhenet dhe mbroje nga dënimi i varrit (dhe nga dënimi i Zjarrit)! (17)

Sa i përket foshnjës, i cili ka vdekur 4 muaj e më shumë, në këtë rast, lutemi për prindërit e tij duke i kërkuar Allahut falje dhe mëshirë, sepse Profeti ﷺ ka thënë: “Foshnjës (në moshën 4 muaj e më shumë) i falet namazi i xhenazes. Në këtë namaz lutja shkon për prindërit e tij, duke i kërkuar Allahut falje dhe mëshirë.” (18)

Pas tekbirit të katërt, imami qëndron i heshtur për një moment të shkurtër, pastaj jep selam nga ana e djathtë vetëm një herë, ashtu si ka vepruar Profeti (19). Lejohet gjithashtu që të japë edhe një selam të dytë nga ana e majtë.(20)

Është sunet që ai që fal namazin të ngrejë duart me çdo tekbir, ashtu si ka vepruar Profeti .ﷺ

Ai që i ka humbur disa nga tekbiret me imamin, e ndjek atë (vazhdon pas tij). Për shembull: nëse hyn në namazin e xhenazes kur imami është në tekbirin e tretë, ai lutet për të vdekurin, pastaj pas tekbirit të katërt të imamit, ai bën tekbir dhe lexon Fatihanë, pastaj bën tekbir dhe dërgon salavate mbi Profetin ,ﷺ pastaj jep selam — nëse arrin ta përfundojë këtë para se të ngrihet xhenazja. Nëse nuk arrin, atëherë jep selam bashkë me imamin dhe nuk ka asgjë për të.

Kush i ka humbur namazi i xhenazes për të vdekurin, lejohet që të falë namaz në varrin e të ndjerit. Kjo do të thotë që e vendos varrin midis tij dhe kibles dhe falet njësoj si në namazin e xhenazes (si në figurën 18), ashtu si ka vepruar Profeti .ﷺ



Gjithashtu është e pëlqyeshme të falet namazi i xhenaze në mungesë, për atë që ka vdekur në një vend tjetër, nëse askush nuk ia ka falur atje.

Muslimanët falin namazin e xhenazes edhe për atë që ka vrrarë veten dhe për banditët, por është e pëlqyeshme që udhëheqësi i vendit dhe dijetarët të mos falin namaz për të, në mënyrë që të shërbejë si paralajmërim dhe pengesë për të tjerët.

Lejohet falja e namazit të xhenazes në xhami, siç ka vepruar Profeti ﷺ.(23)

Por është sunet që të caktohet një vend i veçantë për xhenazet jashtë xhamisë, në mënyrë që xhamia të mos ndotet. Është e pëlqyeshme që ky vend të jetë afër varrezave, për t'ua lehtësuar njerëzve procesin e varrimit.

5- Bartja e xhenazes dhe varrosja

Është e pëlqyer që xhenazja të bartet nga të katër anët e saj mbi supe (siç tregohet në figurën 19).



Është sunet që me xhenazen të ecet shpejt, por jo me nxitim të tepruar, bazuar në fjalën e Profetit ﷺ: “Shpejtojeni me xhenazen.”

Lejohet që njerëzit të ecin para xhenazes, pas saj, në anën e djathtë ose në anën e majtë të saj, sepse të gjitha këto janë transmetuar në Sunet. (24)

Është e papëlqyer që ai që ndjek xhenazen të ulet para se xhenazja të vendoset në tokë, sepse Profeti ﷺ e ka ndaluar këtë.

Është e papëlqyer të varroset i vdekuri në tri kohët kur Profeti ﷺ e ka ndaluar varrimin. Këto janë përmendur në hadithin e Ukbe ibn Amirit (Allahu qoftë i kënaqur me të), i cili tha:

“Janë tri kohë gjatë të cilave i Dërguari i Allahut ﷺ na ndalonte të falnim namaz ose të varrosnim të vdekurit tanë: kur dielli sapo lind, derisa të ngrihet lart; kur dielli është në mes të qiellit (pak para zenitit), derisa të anojë nga perëndimi; kur dielli është afër perëndimit, derisa të perëndojë.” (25)

Kuptimi i fjalës **“kur dielli është në mes të qiellit”** është pak para hyrjes së kohës së drekës.

Lejohet që i vdekuri të varroset natën ose ditën, sipas asaj që është më e lehtë dhe më e përshtatshme, me përjashtim të tri kohëve të përmendura më sipër.

Është sunet që kur gruaja futet në tokë varri të mbulohet me ndonjë perde ose mbulesë, në mënyrë që të ruhet më mirë dinjiteti i saj.

Është sunet që i vdekuri të futet në varr nga pjesa fundore e tij dhe pastaj futet me kujdes gjithë xhenazeja në të (siç tregohet në figurën 20). Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë futet nga ana e kibles (shiko figurën 21).






Lahdi është më i mirë se sheku. Profeti ﷺ ka thënë: “**Lahdi është për ne, ndërsa shekku është për të tjerët.**”(26)

Lahdi është një zgavër (xhep) anash në fundin e varrit që hapet në drejtim të kibles, ku vendoset i vdekuri (si në figurën 22).

Shekku është një gropë e hapur në mes të fundit të varrit, ku vendoset i vdekuri (si në figurën 23).



Është sunet që varri të thellohet mjaftueshëm, në mënyrë që i vdekuri të mbrohet nga kafshët grabitqare dhe të mos përhapet era e trupit.

Ai që e vendos të vdekurin në varr thotë: **“Bismilah ue ala sunneti** (ose: mileti) **Resulilah - Me emrin e Allahut dhe sipas Sunetit** (ose miletit – fesë) **të të Dërguarit të Allahut ﷺ”**. Sepse kështu vepronte Profeti ﷺ. (27)

Më parësor për futjen e të vdekurit në varr është personi që ai e ka lënë amanet, pastaj të afërmit e tij. E nëse nuk ka të tillë, atëherë çdo musliman mund ta kryejë këtë detyrë.

Është sunet që i vdekuri të vendoset në varr mbi anën e tij të djathtë, i kthyer nga kibla (si në figurën 24), bazuar në fjalën e Profetit ﷺ: **“Qabja është kibla juaj, si për të gjallët ashtu edhe për të vdekurit.”** (28)



Nuk vendoset nën kokën e tij diçka si jastëk prej tulle apo guri, sepse për këtë nuk ka argument të saktë.

Gjithashtu, **fytyra e tij nuk zbulohet**, përveç nëse i vdekuri ka qenë në gjndjen e ihramit, siç u përmend më herët.

Pastaj mbyllet hapja e lahdit me tulla balte, ndërsa hapësirat mes tyre mbushen me baltë.

Pas vendosjes së të vdekurit në varr, **është sunet që secili musliman i pranishëm të hedhë tri grushte dhe mbi varrin e tij** (si në figurën 25), ashtu siç veproi Profeti ﷺ. (29)



Është sunet që varri të ngrihet rreth një pëllëmbë mbi tokë, në mënyrë që të dallohet se është varr dhe të mos përdhohet. Varri duhet të ketë formë të ngritur si gunga e devesë (si në figurën 26), sepse kështu ishte varri i Profetit ﷺ (30)



Mbi varr vendosen gurë të vegjël, ashtu siç u veprua me varrin e Profetit ﷺ, (31), që të njihet se është varr dhe të mos cenohet. Më pas, mbi këta gurë hidhet ujë, sepse kjo është transmetuar në Sunet. (32)

Gjithashtu vendoset një gur te pjesa e kokës së varrit për ta dalluar atë, ashtu siç bëri Profeti ﷺ me varrin e Uthman ibn Madhu'nit. (33)

Është e ndaluar të suvatohet varri me allçi apo të lyhet me gëlqere, të ndërtohet mbi të, të shkruhet mbi të, të ulet dikush mbi të, ta shkelë apo të mbështetet në të, sepse Profeti ﷺ i ka ndaluar të gjitha këto. (34)

Është e papëlqyer që dy ose më shumë të vdekur të varrosen në të njëjtin varr, përveç rastit të domosdoshmërisë, kur numri i të vdekurve është i madh dhe mungojnë njerëzit që merren me varrimin e tyre, siç ndodhi me dëshmorët e betejës së Uhudit. Në këtë rast vendoset një shtresë dheu si ndarëse midis secilit prej tyre.

Është e pëlqyeshme që t'i dërgohet ushqim familjes që i ka rënë fatkeqësia, teksa ata janë të preokupuar me dhimbjen për ndarjen nga njeriu i tyre i zemrës, sipas fjalës së të Dërguarit ﷺ kur vdiq Xhafer ibn Ebi Talib (Allahu qoftë i kënaqur me të): “Përgatitni ushqim për familjen e Xhaferit, sepse atyre u ka ardhur ajo (fatkeqësi) që i ka angazhuar (preokupuar).” (35)

Është e papëlqyeshme që familja e të ndjerit të përgatisë ushqim për njerëzit, sipas fjalës së sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur me ta): “Ne e konsideronim përgatitjen e ushqimit (nga familja e të vdekurit) dhe tubimin në shtëpinë e tij si vajtimi.” (36)

6- Vizita e varrezave

Është sunet për burrat të vizitojnë varrezat, për t'u lutur për të vdekurit dhe për të marrë mësim (si në figurën 26), sipas fjalës së të Dërguarit të Allahut ﷺ: “Ju kisha ndaluar nga vizita e varrezave, por tani vizitohet ato, sepse ato ju kujtojnë Ahiretin.” (37)

Sa u përket grave, është e ndaluar (haram) për to të vizitojnë varrezat, sepse i Dërguari i Allahut ﷺ “ka mallkuar gratë që vizitojnë varrezat” (38), sepse ato shpesh janë më pak të durueshme dhe mund të bëjnë veprime të ndaluara, si: goditja e faqeve, vajtimi dhe veprime të tjera, që dhe mund të jenë shkak sprovimi (fitneje) në një vend ku njeriu duhet të kujtojë Ahiretin.

Vizitori i varrezave thotë:

“Es-selāmu alejkum dāra kaumin mu'minīn, ve innā in shā'Allāhu bikum lāhikūn. - Paqja qoftë mbi ju, o banorë të një populli besimtar, dhe ne, nëse do Allahu, do t'ju bashkohemi.” Kështu është transmetuar nga i Dërguari i Allahut ﷺ. (39)

Muslimani duhet të ruhet nga madhërimi i varreve ose kërkimi i bereqetit dhe fërkimi me to; sepse të gjitha këto janë mjete që çojnë në shirk.

7- Ngushëllimi

Është sunet të ngushëllohen familjarët e të vdekurit duke thënë:

“In-ne lil-lâhi mâ ehadhe, ue lehu ma ea'tâ, ue kul-lu shej'in indehu bi exhelin musem-mâ. Fesbir uehtesib. - Vërtet, e Allahut është ajo që e merr dhe e Allahut është ajo që ka dhënë. Çdo gjë tek Ai është me afat të caktuar. Prandaj duro dhe syno të arrish me durimin shpërblimin e Zotit!” Ky është transmetim autentik nga Profeti ﷺ. (40)

Nëse thotë: “Ea'dhamellâhu exhrrake ue ahsene azâeke. - Allahu të dhëntë shpërblim të madh, të bëftë durimtar të mirë”, nuk ka problem.

Lejohet të qajë për të vdekurin pa e tepruar, sepse Profeti ﷺ qau kur vdiq djali i tij, Ibrahim. (41) Ndërsa vajtimi nuk lejohet.

Lejohet që personi i goditur nga fatkeqësia të mbajë zi për shkak të të vdekurit domethënë të lërë tregtinë ose daljet për argëtim e të ngjashme, **për tre ditë vetëm.**

Përveç gruas për burrin e saj, ajo duhet të mbajë zi gjatë periudhës së zisë (iddetit), që është 4 muaj e 10 ditë, nëse nuk është shtatzënë; ndërsa nëse është shtatzënë, mban zi derisa të lindë.

Ndalohet vajtimi dhe nedbi për të vdekurin. *Nedbi* është përmendja e të mirave të të vdekurit, duke vajtuar me zë të lartë, si p.sh. duke thirrur: “O ti që siguroje ushqimin tonë... etj.” Ndërsa **vajtimi** është të qash me zë të lartë dhe me rënkime si vajtimi i pëllumbave. Këto dy veprime ndalohen, sepse shprehin kundërshtim dhe pakënaqësi ndaj kaderit (caktimit) të Allahut.

Janë të ndaluara gjithashtu veprimet e mëposhtme: grisja e rrobave, goditja e faqeve dhe shkulja e flokëve dhe të ngjashme me to, sipas fjalës së të Dërguarit të Allahut ﷺ: “Nuk është prej nesh ai që godet faqet, gris rrobat dhe thërret me thirrje të injorancës”. (42)

Referenca

- 1- Është transmetuar nga Tirmidhiu dhe është saktësuar nga Albani në “El Irua” (682).
- 2- Është transmetuar nga Muslimi.
- 3- Muttefekun alejhi, d.m.th.: e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.
- 4- Muttefekun alejhi.
- 5- Është transmetuar nga autorët e Suneneve dhe është saktësuar nga Albani në “Ahkamu el Xhenaiz” (faqe 14).
- 6- Hadith i saktë, transmetuar nga Ahmed; shiko verifikimin e tij në librin “El Guslu uel Kefenu” të shejh Mustafa el Adau (faqe 46).
- 7- E ka nxjerrë Abdurrezaku në “El Musannaf” (nr. 6117).
- 8- Et-Teube: 84.
- 10- Muttefekun alejhi.
- 11- Është transmetuar nga Buhariu.
- 12- Muttefekun alejhi.
- 13- Është transmetuar nga Muslimi.
- 14- Është transmetuar nga Hakimi dhe është saktësuar nga Albani në “Ahkamu el Xhenaiz” (faqe 51).
- 15- Muttefekun alejhi.
- 16- Është transmetuar nga Ebu Daudi dhe është saktësuar nga Albani në “Ahkamu el Xhenaiz” (faqe 109).
- 17- Është transmetuar nga Muslimi.
- 18- Është transmetuar nga Ebu Daudi dhe është saktësuar nga Albani në “Ahkamu el Xhenaiz” (faqe 80).
- 19- Është transmetuar nga Hakimi dhe zinxhiri i tij konsiderohet *hasen* – i mirë nga Albani në “Ahkamu el Xhenaiz” (faqe 129).
- 20- Shiko: “Ahkamu el Xhenaiz” e Albanit (faqe 127).
- 21- E ka transmetuar Darakutniu dhe zinxhiri i tij është vlerësuar *hasen* - i mirë nga Ibn Bazi, siç është përmendur në fetvatë e tij (12/148).
- 22- Muttefekun alejhi.
- 23- Është transmetuar nga Muslimi.
- 24- Shiko: “Ahkamu el Xhenaiz” e Albanit (faqe 73).
- 25- Është transmetuar nga Muslimi.
- 26- Është transmetuar nga Ebu Daudi dhe është saktësuar nga Albani në “Ahkamu el Xhenaiz” (faqe 145).
- 27- Është transmetuar nga Ebu Daudi dhe është saktësuar nga Albani në “Ahkamu el Xhenaiz” (faqe 152).
- 28- Është transmetuar nga Bejhekiu dhe është saktësuar nga Albani në “El Irua” (690).
- 29- Është transmetuar nga Ibn Maxhe dhe është saktësuar nga Albani në “Ahkamu el Xhenaiz” (faqe 125).
- 30- Është transmetuar nga Buhariu.
- 31- Është transmetuar nga Ebu Daudi.
- 32- Janë transmetuar hadithe të sakta; shiko “El Irua” (3/206).
- 33- Është transmetuar nga Ebu Daudi dhe është saktësuar nga Albani në “Ahkamu el Xhenaiz” (faqe 155).
- 34- Është transmetuar nga Muslimi.
- 35- Është transmetuar nga Ebu Daudi dhe është saktësuar nga Albani në “Ahkamu el Xhenaiz” (faqe 167).

- 36- Është transmetuar nga Ebu Daudi dhe është saktësuar nga Albani në “Ahkamu el Xhenaiz” (faqe 167).
- 37- Është transmetuar nga Muslimi.
- 38- Hadith *hasen* – nivelit të mirë, transmetuar nga autorët e Suneneve.
- 39- Është transmetuar nga Muslimi.
- 40- Muttefekun alejhi.
- 41- Muttefekun alejhi.
- 42- Muttefekun alejhi.

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	3
Agonia e vdekjes, veprimet e para për përgatitjen e xhenazes.....	4
Larja e xhenazes.....	5
Qefinosja.....	11
Namazi i xhenazes.....	15
Bartja e xhenazes dhe varrosja.....	18
Vizita e varrezave.....	24
Ngushëllimi.....	25
Referenca.....	26
Përmbajtja.....	27